

Udhërrëfyes  
për Sinjalizimin  
dhe Sinjalizuesit  
në Shqipëri





**Southeast Europe  
COALITION ON  
WHISTLEBLOWER  
PROTECTION**

Ky udhërrëfyes u realizua nga  
Koalicioni i Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve  
me mbështetjen e National Endowment for Democracy  
Autor: Arjan Dyrmishi

Pikëpamjet dhe mesazhet e përcjella dhe të shprehura në këtë udhëzues janë të autorit  
dhe ilustruesit dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet, mendimet apo qëndrimet e NED apo Koalicionit.

Te gjitha te drejtat jane te autorit



Udhërrëfyes për Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit në Shqipëri



# **Udhërrëfyes për Sinjalizimin dhe Sinjalizuesit në Shqipëri**

# PARATHËNIE

---



**J**anë të rralla ditët në të cilat shqiptarët nuk mësojnë nga mediat se si nëpërmjet formave të ndryshme të korrupsionit shpërdorohen financat, prona apo interesi publik, rrezikohet mjedisi dhe shëndeti apo çenohet ose shtrëmbërohet drejtësia.

Njerëzit që punojnë në institucionet publike apo në kompanitë private janë shpesh të parët që konstatojnë dhe ndeshen me shkelje të ligjit dhe dëmtim të interesit publik por shumica e tyre shpesh heshtin, qëndrojnë indiferentë apo thjesht mendojnë se janë të pafuqishëm për të parandaluar këto probleme.

Megjithëkëtë, nga ana tjetër ka njerëz të cilët mendojnë ndryshe dhe që duan të japin kontributin e tyre në mënyrë që të tilla gjëra të mos ndodhin ose nëse ndodhin përgjegjësit të marrin ndëshkimin sipas ligjit.

Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në Qershor 2016, përbën një instrument të rëndësishëm antikorrupsion pasi u vjen në ndihmë të gjithë punëmarrësve, si dhe të gjithë atyre që kanë marrdhënie kontraktuale të caktuara me një institucion publik apo kompani private që të sinjalizojnë veprimet korruptive me të cilat ndeshen.

Por është e rëndësishme që qytetarët ta kuptojnë dhe zbatojnë ligjin në mënyrë të tillë që bën të mundur arritjen e qëllimit për të cilin ai është miratuar. Mungesa e të kuptuarit të qartë të ligjit jo vetëm që nuk shpie në arritjen e qëllimit të tij por mund të dëmtojë të punësuarin apo interesat e tij.

Çdo person i cili vendos të sinjalizojë duhet të jetë shumë i qartë për sfidat pozitive dhe negative me të cilat ka gjasa të ballafaqohet si dhe të jetë i përgatitur psikolog-

jikisht dhe emocionalisht për t'u përballur me këto sfida. Po kështu është e rëndësishme që sinjalizuesit të jenë të vetëdijshëm për llojet e ndihmës dhe mbështetjes që ata mund të marrin nga institucionet përgjegjëse sipas ligjit në mënyrë që të kalojnë sa më lehtë sfidat me të cilat mund të përballen.

Ky udhërrëfyes është zhvilluar me qëllim që të prezantojë në mënyrë sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve duke u munduar që t'u japë përgjigje pyetjeve të cilat sinjalizuesit mund t'i bëjnë vehtes përpara, gjatë apo mbas sinjalizimit.

Udhërrëfyesi ofron një mundësi për qytetarët që të njohin më mirë rrugët dhe mënyrat që jep Ligji për raportimin e akteve korruptive dhe ndihmon sinjalizuesit për ta përdorur Ligjin në mënyrë sa më të efektshme për mbrojtjen e tyre.

# H Y R J E

---



**K**orrupsioni është abuzimi me besimin e dhënë për përfitime personale.

Korrupsioni shfaqet në forma dhe mënyra të ndryshme dhe përfshin persona të cilët mbajnë poste publike apo të tjerë që punojnë në sektorin privat.

Një formë e përhapur e korrupsionit është pagesa e ryshfetit nga ana e njerëzve të biznesit me qëllim përfitimin e kontratave për mallra, shërbime apo punime publike. Ndërkohë shumë njerëz të zakonshëm u paguajnë ryshfet nëpunësve publikë për të marrë një shërbim, për të siguruar punësim apo për të fituar një të drejtë shkollimi për fëmijët e tyre. Nga ana tjetër, ka politikanë të cilët nxisin qytetarët për të votuar për ta duke iu ofruar para, ushqime apo sende që u nevoiten. Po kështu zyrtarë publikë rrisin në mënyrë artificiale dhe të padrejtë koston e projekteve me qëllim për të futur në xhep diferencën. Në kryerjen e detyrave të tyre shumë

profesionistë të fushave të ndryshme si administratorët, kontabilistët, arkitektët, punonjësit e bankave, siguruesit, juristët, prodhuesit, farmacistët, etj., angazhohen në praktika të paligjshme për t'u pasuruar personalisht duke i sjellë vendit dhe ekonomisë dëm të pallogaritshme.

Por korrupsioni shkon përtej dhënies dhe marrjes së ryshfetit. Përveç krimeve ekonomike, shumë forma të tjera të korrupsionit të cilat ndikojë negativisht në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit janë moszbatimi i ligjit, keqmenaxhimi i burimeve publike ose përdorimi i tyre për qëllime të tjera, shkatërrimi i mjedisit, angazhimi në veprime të cilat kërcënojnë ose rrezikojnë sigurinë e individëve dhe publikut, deformimi dhe prishja e drejtësisë, etj.

Edhe pse Shqipëria ka shumë ligje për të adresuar korrupsionin dhe format të ndryshme të tij, këto ligje nuk janë gjithmonë të efektshme. Shkaku kryesor qëndron në faktin



se shumica e praktikave korruptive ndodhin në fshehtësi dhe ata që angazhohen në korrupsion marrin masa të mbuluar gjurmët e tyre dhe për t'iu shmangur hetimit dhe drejtësisë.

Njerëzit që punojnë në institucione publike apo kompani private konstatojnë ose i ndeshin shpesh këto shkelje të ligjit dhe interesit publik. Megjithatë shumica qëndrojnë indiferentë pasi mendojnë se janë të pafuqishëm për të bërë ndonjë gjë për të parandaluar këto veprime apo nga frika e hakmarrjes. Dhe me të drejtë, nuk janë të panjohura për ta rastet kur në vend që të falenderimit për qëndrimin kundër shkeljeve të tilla kolegë të tyre janë ndëshkuar me heqje nga puna, transferim, kërcënime apo edhe duke i paditur në gjykata.

Për të thyer këtë rreth vicioz dhe me qëllim që të inkurajojë punëmarrësit dhe të gjithë ata që kanë marrdhënie kontraktuale të caktuara me një institucion publik apo kompani private që të raportojnë aktet korruptive që konstatojnë apo ndeshen,

Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Përveç kontributit gjatë hartimit dhe miratimit të këtij Ligji, Koalicioni i Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve ka zhvilluar këtë udhërrëfyes me qëllim për ta bërë Ligjin sa më të kuptueshëm për qytetarët dhe me premisën se çdo punonjës ka të drejtë të ngrejë shqetësime për shkeljet dhe paligjshmërinë në vendin e punës pa frikën e hakmarrjes.

Udhërrëfyesi u drejtohet kryesisht punonjësve të cilët ndeshen me vepra korruptive dhe që kanë vullnetin për t'i sinjalizuar ato. Punonjësit kanë një rol aktiv në zbulimin e korrupsionit dhe ata duhet të njohin në mënyrë sa më të thjeshtë dhe praktike si ta japin këtë kontribut nëpërmjet sinjalizimit dhe si ta përdorin Ligjin për të kërkuar mbrojtje nga çdo masë hakmarrëse apo ndëshkimore që mund të vijë si rezultat i sinjalizimit.

Përveç qytetarëve udhëzuesin do ta gjejnë të dobishëm edhe përdorues të tjerë të tij si zyrtarë të njesive përgjegjëse, gazetarë dhe anëtarë të shoqërisë civile.







## Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit si instrument antikorrupsion

**K**uvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve si një mjet i rëndësishëm anti-korrupsion.

Qëllimi i Ligjit është përmirësimi i aftësisë së vendit për të luftuar korrupsionin dhe forma të tjera të sjelljes së paligjshme që ndikojnë negativisht në zhvillimin tonë. Ligji bazohet në idenë se në qoftë se punonjësve u jepet kompetenca për të zbuluar veprat korruptive pa frikën e hakmarrjes çdo vit do të shpëtohen nga shpërdorimi miliona Euro, do të rritet cilësia e shërbimeve dhe do të forcohet integriteti në institucionet publike dhe sektorin privat. Të gjitha së bashku këto do të kontribuojnë në zhvillimin më të shpejtë të vendit.

Bazuar në Kodin Penal, Ligji për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve konsideron si vepra penale të korrupsionit për të cilat mund të sinjalizohet, të gjitha ato veprime ose mosveprime të kundërligjshme, sipas legjislacionit penal në fuqi në lidhje me çdo formë të korrupsionit aktiv dhe pasiv, shpërdorimin e detyrës ose të kompetencave, ushtrimin e



ndikimeve të paligjshme në kryerjen e detyrave apo marrjen e vendimeve, shpërdorimin e të ardhurave të buxhetit të shtetit, përfitimin e paligjshëm, mitdhënien apo mitmarrjen, si dhe çdo akt tjetër të ngjashëm me sa më sipër.

Ligji parashikon tri elementet themelore të një ligji gjithëpërfshirës mbi sinjalizimin:

- Mekanizmat për sinjalizimin e veprave korruptive.
- Mekanizmat për hetimin e sinjalizimeve të kryera.
- Mekanizmat për mbrojtjen e sinjalizuesve nga hakmarrja.

Ligji është i zbatueshëm për të gjithë personat që punojnë në sektorin publik ose privat dhe përfshin disa nga praktikatat më të mira ndërkombëtare për mbrojtjen e sinjalizuesve, të tilla si:

- mbrojtje të besueshme konfidencialitetit.
- mbrojtje kundër ngacmimeve që synojnë të krijojnë një mjedis të rënduar për sinjalizuesin.
- ndalimin e marrveshjeve kontraktuale në bazë të së cilave përjashtohen ose kufizohen të drejtat dhe mbrojtja e sinjalizuesit.
- mundësia e transferimit në rast se sinjalizuesi për të mbrojtur veten nga reagime armiqësore në mjedisin e tij të afërt të punës zgjedh që të mos kthehet në të njëjtin vend pune.
- ngarkimi me përgjegjësi personale për hakmarrje ndaj sinjalizuesit.

Ky udhërrëfyes synon të shërbejë si një instrument didaktik për njohjen sa më të mirë dhe zbatimin sa më efikas të Ligjit për Sinjalizimin dhe Mbrojtjen e Sinjalizuesve.

Udhërrëfyesi është i ndërtuar në një format pyetjesh dhe përgjigjesh. Konkretisht udhërrëfyesi u përgjigjet 50 pyetjeve të cilat sinjalizuesit mund t'i ngrenë në mënyrë më të shpeshtë gjatë zbatimit të ligjit:



# PËRMBAJTJE

# P È R M B A J T J E

- 1.** Çfarë është sinjalizimi?
- 2.** Çfarë është sinjalizuesi?
- 3.** A mund të sinjalizoj për këdo?
- 4.** A jam i detyruar të sinjalizoj?
- 5.** A mund të sinjalizoj nëse jam i punësuar në sektorin privat?
- 6.** A mund të sinjalizoj nëse nuk jam në mardhënie të përhershme pune?
- 7.** Ku mund ta bëj sinjalizimin?
- 8.** A kanë të gjitha institucionet publik dhe ndërmarrjet private njesi përgjegjëse?
- 9.** Ku mund të sinjalizoj nëse institucioni ose ndërmarrja ku punoj nuk ka njesi përgjegjëse për sinjalizimin?
- 10.** A mund të sinjalizoj për një akt korrupsioni në një institucion ose ndërmarrje të ndyshme nga ajo ku punoj?
- 11.** A është detyrim sinjalizimi i brendshëm?
- 12.** Çfarë detyrimesh ka njesia përgjegjëse për sinjalizimin?
- 13.** Në ç'formë mund ta bëj një sinjalizim?
- 14.** A mund të bëj një sinjalizim nëpërmjet telefonit ose e-mail-it?
- 15.** A mund të sinjalizoj në mënyrë anonime?
- 16.** A mund të bëj sinjalizimin tek një gazetar?
- 17.** Cilat janë përfitimet e sinjalizimit në krahasim me raportimin tek një gazetar?
- 18.** Mbasi ta kem kryer sinjalizimin, a mund ta bëj publik tek një gazetar?
- 19.** Si duhet t'i trajtoj kërkesat e medias për intervista dhe komente gjatë kohës që sinjalizimi që kam kryer është duke u hetuar?
- 20.** A mund të denoncoj tek një punonjës policie në vend të sinjalizimit?
- 21.** A mund autorizoj avokatin për të bërë sinjalizimin?
- 22.** A më pengon Ligji për sinjalizimin t'i drejtohem gjykatës?
- 23.** Cila është fryma e ligjit?
- 24.** Cilat janë përfitimet e Ligjit?
- 25.** Kur një sinjalizim është i mbrojtur?
- 26.** A ka kushte për një sinjalizues që të mbrohet nga ligji?



27. Çfarë nënkuptohet me "dyshim në mirëbesim" si kusht për të pranuar një sinjalizim?
28. Si mund të dalloj një interes publik nga pakënaqësia personale?
29. A mund të nisem nga një interes personal për të sinjalizuar?
30. Kur sinjalizimi nuk është në mirëbesim?
31. Cila është procedura e saktë e sinjalizimit?
32. Cilat janë format e mbrojtjes?
33. A mund të paditem për kryrjen e një sinjalizimi të pasaktë?
34. A mund të më detyrojë punëdhënësi të nënshkruaj ndonjë akt që më ndalon sinjalizimin?
35. Çfarë ndodh nëse njesia përgjegjëse ose personi tek i cili raportoj nuk e mban konfidencial informacionin e dhënë?
36. Çfarë duhet të mbaj parasysh kur vendos për të sinjalizuar një akt korrupsioni?
37. Çfarë do të bëjë personi apo personat tek të cilit do të sinjalizoj?
38. A jam i detyruar të zbuloj burimet e informacionit mbi sinjalizimin?
39. Kush është përgjegjës për hetimin e sinjalizimit?
40. Çfarë ndodh nëse hetimi vertëton se sinjalizimi mbi aktin e korrupsionit është i bazuar?
41. Çfarë mund të bëj në qoftë se jam duke u viktimizuar?
42. Sa zgjat procedura e vlerësimit të kërkesës për mbrojtje?
43. Çfarë ndodh nëse nga hetimi rezulton se jam viktimizuar?
44. Çfarë ndodh nëse institucioni publik apo subjekti privat nuk e zbaton vendimin për riparimin e shkeljes?
45. A mund ta ndryshoj vendin e punës nëse jam duke u viktimizuar?
46. Kush mund të më këshillojë në mënyrë konfidenciale nëse kam dyshime për sinjalizimin?
47. Cilat janë përgjegjësitë e punëdhënësit në lidhje me sinjalizimin?
48. Çfarë mund të pres mbasi kam bërë një sinjalizim?
49. A mund të sinjalizoj nëse punoj në një institucion i cili trajton informacione të kalisifikuara sekret?
50. Për sa kohë ruhen të dhënat personale të sinjalizimit?

# Pyetje të shpeshta



## 1 Çfarë është sinjalizimi?

Sinjalizimi është akti i zbulimit tek publiku nga një person, zakonisht i punësuar, i akteve të paligjshme dhe korruptive, keqmanaxhimi apo akte të tjera keqbërje. Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit e kufizon sinjalizimin vetëm për veprime apo praktika të dyshuara korupsioni.



## 2 Ç'është sinjalizuesi?

Këshilli i Europës përkufizon si sinjalizues çdo person i cili raporton ose zbulon informacion mbi një kërcënim apo dëm të interesit publik në kontekstin e marrëdhënieve të tij të punës. Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit përkufizon si sinjalizues një individ i cili sinjalizon një veprim ose praktikë të dyshuar korupsioni.

*Sinjalizuesi e kryen sinjalizimin në kushtet e mirëbesimit dhe nuk motivohet nga interesi personal apo për të demtuar dikë tjetër.*



## 3 A mund të sinjalizoj për këdo?

Po. Ju mund t'i fryni bilbilit për çdo person apo institucion sa kohë që ju keni arsye të qënësishme për të besuar se keni informacion të besueshëm mbi një akt korupsioni. Asnjë person nuk është mbi ligjin, dhe ju mund të sinjalizoni për çdo person apo institucion.



#### **4 A jam i detyruar të sinjalizoj?**

Sinjalizimi është një veprim vullnetar dhe askush nuk mund të detyrohet të sinjalizojë.



#### **5 A mund të sinjalizoj nëse jam i punësuar në sektorin privat?**

Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesit është i zbatueshem qoftë në sektorin publik ose privat. Akte korruptive të cilat dëmtojnë interesin publik mund të kryhen si në sektorin publik ashtu edhe atë privat.



#### **6 A mund të sinjalizoj nëse nuk jam në marrdhënie të përhershme pune?**

Përveç punonjësve në marrdhënie të përhershme pune, mund të sinjalizoni edhe nëse jeni aplikant ose keni punuar më parë pranë subjektit privat apo publik, pavarësisht nga natyra e marrëdhënies së punës ose kohëzgjatjes së saj, si dhe nëse paguheni ose jo.



## 7 Ku mund ta bëj sinjalizimin?

Nëse gjatë punës viheni në dijeni të veprimeve ose praktikave të korrupsionit sinjalizimin mund ta bëni tek njësia përgjegjëse brenda institucionit publik ose ndërmarrjes private ku punoni ose tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Sinjalizimi i kryher tek njësia përgjegjëse brenda institucionit publik ose ndërmarrjes private quhet sinjalizim i brendshëm.

Sinjalizimi i kryer tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave quhet sinjalizim i jashtëm.



## 8 A kanë të gjitha institucionet publike dhe ndërmarrjet private njësi përgjegjëse për sinjalizimin?

Njesitë përgjegjëse gjenden vetëm pranë institucioneve publike me më shumë se 80 të punësuar, dhe subjekteve private me më shumë se 100 të punësuar.



## 9 Ku mund të sinjalizoj nëse institucioni ose ndërmarrja ku punoj nuk ka njësi përgjegjëse për sinjalizimin?

Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave shërben si njësi përgjegjëse për sinjalizimin për institucionet publike ose ndërmarrjet private të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.





## 10 A mund të sinjalizoj për një akt korrupsioni në një institucion ose ndërmarrje të ndryshme nga ajo ku punoj?

Po. Nuk përjashtohet që të sinjalizoni për një akt korrupsioni të një institucioni publik apo ndërmarrje private të ndryshme nga ajo në të cilën punoni. Është detyrë e njesive përgjegjëse dhe e Inspektoratit të Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave që të shqyrtojnë rastin kur të sinjalizuarit i përkasin institucioneve apo ndërmarrjeve të ndryshme.



## 11 A është detyrim sinjalizimi i brendshëm?

Nëse e gjykon të arsyeshme, sinjalizuesi mund të kryejë sinjalizimin tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, pavarësisht nga ekzistenca e njësisë për sinjalizimin e brendshëm në institucionin publik ose ndërmarrjen private.

Nëse zgjidhni të sinjalizoni tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive atëherë nevojitet të parashtroni shkaqet dhe rrethanat e kësaj zgjedhjeje.



## 12 Çfarë detyrimesh ka njësia përgjegjëse për sinjalizimin?

Njësia përgjegjëse brenda institucionit publik ose ndërmarrjes private, e cila mund të përbëhet nga një ose më shumë punonjës, ka për detyrën të shqyrtojë nëse mbas sinjalizimit do të kryhet hetimi administrativ si dhe të shqyrtojë kërkesën e sinjalizuesit për mbrojtje, nëse sinjalizuesi e kërkon.



### 13 Në ç'formë mund ta bëj një sinjalizim?

Sinjalizimin mund ta bëni me shkrim ose me gojë përpara punonjësve të njesisë përgjegjëse brenda institucionit publik ose ndërmarrjes private ose tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Që të jetë i vlefshëm sipas ligjit, sinjalizimi duhet të përmbajë:

- të dhënat e identitetit të sinjalizuesit dhe të dhënat e kontaktit.
- përshkrimin e fakteve e të rrethanave për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.



### 14 A mund të të bëj një sinjalizim nëpërmjet telefonit ose e-mail-it?

Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve parashikon se sinjalizimi mund bëhet me çdo mjet komunikimi. Kjo presupozon edhe komunikimin elektronik. Megjithatë, që sinjalizimi të quhet i vlefshëm, nevojitet që sinjalizuesi të kontaktojë fizikisht punonjësit e njesisë së brendshme të sinjalizimit ose të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.



### 15 A mund të sinjalizoj në mënyrë anonime?

Ju mund të zgjidhni të sinjalizoni në mënyrë anonime dhe sinjalizimi të pranohet, nëse arsyetoni shkaqet e anonimatit dhe nëse të dhënat e sinjalizuara përbëjnë një bazë të mjaftueshme për të hetuar administrativisht veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit.



## 16 A mund të bëj sinjalizimin tek një gazetar?

Kryerja e sinjalizimit tek gazetarët nuk është në përputhje me ligjin dhe për këtë arsye, nëse zgjidhni të sinjalizoni tek një gazetar apo subjekt tjetër, atëherë nuk gëzoni të drejtën e mbrojtjes nga viktimizimi sipas ligjit.

## 17 Cilat janë përfitimet e sinjalizimit në krahësim me raportimin tek një gazetar?

Kryerja e sinjalizimit tek njesitë përgjegjëse sipas ligjit ka shumë përparësi. Minimalisht sinjalizuesi ka garancinë se:

- Informacioni i raportuar do të hetohet nga persona ose institucione kompetente.
- Njësia përgjegjëse ose Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave njoftojnë sinjalizuesin për çdo masë të marrë në përgjigje të sinjalizimit.
- Sinjalizuesi merr pjesë në hetimin administrativ.
- Sinjalizuesi merret në mbrojtje ndaj çdo hakmarrje apo viktimizimi.
- Hetimi mund të shpjerë në ndjekjen penale të personave të përfshirë në korrupsion dhe në gjetjen apo rikthimin e vlerave të humbura si pasojë e korrupsionit.



## **18** Mbasi ta kem kryer sinjalizimin, a mund ta bëj publik tek një gazetar?

Jo. Sipas ligjit sinjalizuesi është i detyruar të ruaje konfidencialitetin e sinjalizimit dhe të mos e bëjë atë publik.

Po kështu sinjalizuesi nuk duhet ta diskutojë sinjalizimin me njerëz të tjerë të cilët mund ta bejnë atë publik.

Në rast se sinjalizuesi e bën publik sinjalizimin apo është përgjegjës për bërjen publike të sinjalizimit, atëherë ai e humbet të drejtën e mbrojtjes.

## **19** Si duhet t'i trajtoj kërkesat e medias për intervista dhe komente gjatë kohës që sinjalizimi që kam kryer është duke u hetuar?

Pavarësisht procedurave dhe masave për ta mbajtur sinjalizimin konfidencial, mund të ndodhë që të dhënat e sinjalizuara nga ju mund të bëhen publike për shkak të pakujdesisë apo edhe për arsye të qëllimita të personave të ngarkuar me trajtimin e informacionit dhe hetimin e sinjalizimit.

Në rast se kjo ndodh dhe kontaktoheni nga media, duhet që të shmangni nxjerrjen e çdo të dhëne apo informacioni që lidhet me sinjalizimin për aq kohë sa të përfundojë hetimi i sinjalizimit.



## 20 A mund të denoncoj tek një punonjës policie në vend të sinjalizimit?

Në thelb sinjalizimi është e njëjta gjë si dhënia e informatave mbi një akt korruptiv një punjësi policie apo dhe gazetari.

Megjithatë ka një dallim ndërmjet të dyjave. Nëse do të bëni një sinjalizim sipas ligjit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve, njesia përgjegjëse ku keni kryer sinjalizimin ka për detyrë që të përfundojë një hetim administrativ të sinjalizimit sa më shpejt të jetë e mundur por jo më vonë se 60 ditë nga data e fillimit të hetimit. Ndryshe, nëse e raportoni në polici, nuk është e detyrueshme që policia të veprojë mbi informacionin e dhënë.

## 21 A mund autorizoj avokatin për të bërë sinjalizimin?

Ndërmjet të tjerave, ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve bazohet në parimin e konfidencialitetit dhe hetimit administrativ të sinjalizimit në mënyrë të shpejtë duke shmangur sistemin gjyqësor.

Për pasojë, marrëdhënia e sinjalizuesit me njesinë përgjegjëse të sinjalizimit është individuale dhe nuk parashikohet që sinjalizuesi të përfaqsohet me avokat për aq kohe sa ndonjë nga palët apo personat e intresuar nuk i është drejtuar gjykatës.





## 22 A me pengon Ligji për sinjalizimin t'i drejtohem gjykatës?

Jo. Nëse në përfundim të një hetimi administrativ rezulton se ndaj sinjalizuesit është kryer një akt hakmarrjeje, dhe institucioni apo personat përgjegjës nuk zbatojnë urdhërin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për riparimin e shkeljes, atëherë sinjalizuesi ka të drejtë të kërkojë në gjykatë riparimin e dëmtimit të shkaktuar nga akti i hakmarrjes apo shpërblim për dëmin e pësuar.



## 23 Cila është fryma e ligjit?

Ligji mbështet vlerat demokratike të dinjitetit njerëzor, lirisë së shprehjes dhe barazisë përpara ligjit.

Ligji synon të garantojë që punonjësit të mund të flasin për aktet korruptive por ta bëjnë këtë në mënyrë të përgjegjshme duke dhënë dhe rregullat për kryerjen e sinjalizimit.

Ligji pohon se korrupsioni është i papranueshëm si në sektorin publik edhe në atë privat dhe se çdo punëdhënës duhet të garantojë që punonjësit të cilët sinjalizojnë akte të korrupsionit janë të mbrojtur nga hakmarrja dhe viktimizimi.



## 24 Cilat janë përfitimet e Ligjit?

Ligji mbron nga hakmarrja dhe viktimizimi të gjithë të punësuarit të cilët sfidojnë aktet korruptive të ndeshura në vendin e punës, në sektorët publikë dhe privatë.

Ai përcakton se çfarë mund të sinjalizoni, si të sinjalizoni dhe kujt mund t'ia bëni sinjalizimin. Ligji përcakton gjithashtu se si mund të kërkoni dhe merrni mbrojtje nga hakmarrja dhe viktimizimi.

Ligji krijon në mjediset e punës një kulturë e cila i ndihmon punonjësit të flasin për aktet korruptive dhe të paligjshme.

Në tërësi ligji inkurajon parandalimin dhe goditjen e korrupsionit.

## 25 Kur një sinjalizim është i mbrojtur?

Një sinjalizim është i mbrojtur kur shkelja është raportuar duke përdorur procedurën e duhur. Në mënyrë që të jetë i mbrojtur, sinjalizuesi duhet të sinjalizojë vetëm tek personat dhe institucionet e përcaktuara në ligjin për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.

**Raportim • Procedura e duhur = Sinjalizim i mbrojtur**

## 26 A ka kushte për një sinjalizues që të mbrohet nga ligji?

Po. Në raportimin e një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni sinjalizuesi duhet të ketë motive të pastra dhe të ndershme dhe arsye për të besuar se informacioni i raportuar është i vërtetë.





## **27** Çfarë nënkuptohet me “dyshim në mirëbesim” si kusht për të pranuar një sinjalizim?

Një person i cili ka për qëllim të zbulojë një akt korrupsioni duhet të ketë shkaqe të arsyeshme për veprimin që ndërmerr. Kjo do të thotë se para se të sinjalizojë, një person duhet të jetë i sigurt së pari se një akt korrupsioni ka ndodhur, po ndodh ose ka të ngjarë të ndodhë. Kështu, vetëm dyshimet nuk janë të mjaftueshme. Sinjalizuesi duhet të ketë të dhëna që e provojnë dyshimin qoftë edhe për shkak se për të hetuar do të duhet të shpenzohet kohë dhe burime njerzore dhe materiale, që në rast se dyshimet do të ishin të pa mbështetura do të shkonin dëm. Së dyti, sinjalizuesi duhet të jetë i bindur që nuk është duke u nisur nga interesi publik dhe jo motive apo pakënaqësi personale.

## **28** Si mund të dalloj një interes publik nga pakënaqësia personale?

Mund të ndodhë që të besoni se jeni duke sinjalizuar një akt kurrptiv apo jo të ligjshëm kur në fakt bëhet fjalë për një ankesë apo pakënaqësi personale. Kjo do të thotë se ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nuk mbulon ankesat personale. Kur vendosni të bëni një sinjalizim, duhet të jeni të bindur se jeni duke vepruar në interes të publikut.





## 29 A mund të nisem nga një interes personal për të sinjalizuar?

Në parim, motivet për tërheqjen e vëmendjes ndaj një problemi nuk duhet të merren parasysh. Mbi të gjitha, nëse një veprim i caktuar dëmton interesin publik, ai duhet trajtuar. Por në praktikë motivet janë të rëndësishme. Për shembull, nëse sinjalizon një akt korruptiv të eprorit dhe motivi yt për të sinjalizuar është dëshira për të marrë atë detyrë mbas largimit të eprorit, atëherë kjo mund të shpjerë në një perceptim të shtrëmbëruar të rëndësisë së çështjes që sinjalizoni. Nëse motivet tuaja janë të dyshimta, atëherë nuk do të jeni aq i efektshëm në trajtimin e problemit dhe mbi të gjitha, një rrezik që ju rrethojnë do të shohin se veprimet tuaja lidhen me interesin personal.



## 30 Kur sinjalizimi nuk është në mirëbesim?

Raste kur sinjalizimi nuk është në mirëbesim mund të jene nëse ai motivohet nga përfitimi personal, tërheqja e vëmendjes së medias dhe publikut apo nga dëshira për t'u hakmarrë ndaj institucionit apo ndërmarrjes.



### 31 Cila është procedura e saktë e sinjalizimit?

- Sinjalizuesi raporton në mirëbesim për një akt korrupsioni tek njesia përgjegjëse në institucionin publik ose ndërmarrjen private në formën e duhur ose tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (shih pyetjen: Në çfarë forme mund të bëj një sinjalizim?)
- Sinjalizuesi paraqet tek njesia përgjegjëse ose tek Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kërkesën për mbrojtje nëse mendon se është subjekt i një akti hakmarrjeje.
- Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ndërmer hetim administrativ dhe përcakton se ka shkaqe të arsyeshme për të besuar që ka ndodhur, është duke ndodhur, ose pritet të ndodhë një akt hakmarrjeje.

### 32 Cilat janë format e mbrojtjes?

Nëse sinjalizoni sipas procedurave të ligjit, atëherë jeni të mbrojtur ndaj çdo mase hakmarrëse të marrë nga institucioni publik apo ndërmarrja private, përfshirë:

- shkarkimin nga puna;
- pezullimin nga puna ose të një ose më shumë detyrave;
- transferimin brenda ose jashtë organizatës;
- uljen në detyrë;
- uljen e pagës dhe/ose të shpërblimeve financiare;
- humbjen e statusit dhe të privilegjeve;
- mosngritjen në detyrë;
- heqjen e së drejtës për të marrë pjesë në trajnime;
- vlerësime negative në marrëdhënien e punës;
- forma të tjera të hakmarrjes në lidhje me punën.



### 33 A mund të paditem për kryrjen e një sinjalizimi të pasaktë?

Në rast se nga shqyrtimi paraprak i sinjalizimit njësia përgjegjëse ose Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave konkludojnë se sinjalizuesi nuk ka vepruar në kushtet e mirëbesimit, apo se sinjalizimi nuk është depozituar sipas procedurës së kërkuar, atëherë vendosin për mosfillimin e hetimit administrativ. Ky vendim nuk ka sjell ndonjë pasojë për sinjalizuesin.

Një sinjalizues mund të paditet nëse sinjalizimi përmban informacion të klasifikuar dhe sinjalizuesi është përgjegjës për zbulimin e sekretit.

Po kështu sinjalizuesi mund të rrezikojë të paditet nga i sinjalizuari nëse sinjalizimi është kryer në mënyrë abuzive ose shpifëse dhe nëse i sinjalizuari merr dijeni për sinjalizimin. Edhe pse njesitë përgjegjëse janë të detyruara të ruajnë konfidencialitetin nuk përjashtohet që kjo të ndodhë.



### 34 A mund të më detyrojë punëdhënësi të nënshkruaj ndonjë akt që më ndalon sinjalizimin?

Sipas ligjit, nënshkrimi i çdo akti marrëveshje që përjashtohen ose kufizohen të drejtat dhe mbrojtjen e sinjalizuesit është i pavlefshëm. Të drejtat e sinjalizuesit kanë epërsi ndaj marrëveshjeve të konfidencialitetit ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësve.





### 35 Çfarë ndodh nëse njësi përgjegjëse ose personi tek i cili raportoj nuk e mban konfidencial informacionin e dhënë?

Aftësia për të mbajtur informacionin e raportuar konfidencial ka rëndësi për zbatimin me sukses të ligjit. Për këtë arsye ligji ka parashikuar masa administrative dhe gjyqësore, në rast se njësi ose personat përgjegjëse shkelin detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit.

### 36 Çfarë duhet të mbaj parasysh kur vendos për të sinjalizuar një akt korrupsioni?

Një sinjalizues duhet të mbajë parasysh se pavarësisht detyrimit ligjor për të marrë sinjalizime, personat përgjegjës për të marrë sinjalizimet mund të mos ndërmarin veprimet e duhura. Për këtë mund të ketë disa arsye: personat përgjegjës për të marrë sinjalizimet mund të mos jenë të interesuar pasi mund të kenë interesa personale me çështjen ose me personin/personat ndat të cilit/cilëve bëhet sinjalizimi. Mundet që personi përgjegjës për marrjen e sinjalizimit paralajmërojnë personat ndaj të cilëve është bërë sinjalizimi apo të shkatërrojë provat. Prandaj, kur vendos të sinjalizojë një sinjalizues duhet të marrë parasysh disa faktorë:

- Besimin e arsyeshëm apo frikën se sinjalizuesi mund të shkarkohet, pezullohet, diskriminohet ose frikësohet;
- Besimin e arsyeshëm apo frikën se dikush mund të fshehë ose të shkatërrojë provat që tregojnë për aktin korruptiv;
- Besimin e arsyeshëm se personi që merr sinjalizimin nuk do të pengojë arritjen e qëllimit të sinjalizimit;
- Seriozitetin e aktit korruptiv të kryer dhe shpejtësinë me të cilën duhet vepruar;
- Mundësinë e ruajtjes së një kopje të provave mbi aktin korruptiv të sinjalizuar.





### 37 Çfarë do të bëjë personi apo personat tek të cilët do të sinjalizoj?

Mbas kryerjes së sinjalizimit personat përgjegjës e regjistrojnë sinjalizimin në një regjistër të posaçëm protokolli dhe në një regjistër elektronik. Rregjistrimi i sinjalizimit është i detyrueshëm dhe nuk mund të refuzohet për asnjë shkak.



### 38 A jam i detyruar të zbuloj burimet e informacionit mbi sinjalizimin?

Nëse e konsideron të arsyeshëm, një sinjalizues nuk është i detyruar të zbulojë burimet e informacionit si gjatë sinjalizimit ashtu edhe gjatë procesit të hetimit administrativ.



### 39 Kush është përgjegjës për hetimin e sinjalizimit?

Hetimi i sinjalizimit kryhet nga njësi përgjegjëse ku është kryer sinjalizimi, që mund të jetë njësi përgjegjëse në institucionin publik apo ndërmarrjen private ose Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave heton sinjalizimin për ato institucione ose ndërmarrje të cilat nuk kanë një njësi përgjegjëse për këtë qëllim.





#### **40** Çfarë ndodh nëse hetimi vërteton se sinjalizimi mbi aktin e korrupsionit është i bazuar?

Nëse nga hetimi rezulton se sinjalizimi për veprimin ose praktikën e dyshuar të korrupsionit është i bazuar, atëherë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave ia kalon hetimin menjëherë prokurorisë ose Policisë së Shtetit.



#### **41** Çfarë mund të bëj në qoftë se jam duke u viktimizuar?

Nëse sinjalizuesi beson se është subjekt i një akti hakmarrjeje, atëherë ai/ajo paraqet kërkesë për mbrojtje të njësisë përgjegjëse tek e cila ka kryer sinjalizimin. Në rast se njësisë përgjegjëse nuk e përmbush kërkesën brenda afatit prej 10 ditë, atëherë kërkesa i paraqitet Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave i cili merr vendim brenda 10 ditëve.



#### **42** Sa zgjat procedura e vlerësimit të kërkesës për mbrojtje?

Procedura e hetimit administrativ të kërkesës për mbrojtje përfundon sa më shpejt të jetë e mundur dhe në çdo rast jo më vonë se 60 ditë nga data e regjistrimit të kërkesës.



### **43 Çfarë ndodh nëse nga hetimi rezulton se jam viktimizuar?**

Nëse në përfundim të hetimit administrativ rezulton se ndaj sinjalizuesit është kryer një akt hakmarrjeje, atëherë Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave urdhëron institucionin publik apo subjektin privat për marrjen e masave për riparimin e shkeljes së kryer.

### **44 Çfarë ndodh nëse institucioni publik apo subjekti privat nuk e zbaton vendimin për riparimin e shkeljes?**

Nëse institucionin publik apo subjektin privat nuk merr masat e urdhëruara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, atëherë sinjalizuesi ose Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kanë të drejtë t'i drejtohen Gjykatës për të kërkuar shpërbtim për dëmin e pësuar nga akti i hakmarrjes.





#### **45 A mund të kërkoj të ndryshoj vendin e punës nëse jam duke u viktimizuar?**

Po. Për të mbrojtur sinjalizuesin nga reagime armiqësore në mjedisin e afërt të punës, institucioni publik, ndërmarrrja private ose Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave merr masat që sinjalizuesi të vendoset në një strukturë tjetër.

#### **46 Kush mund të më këshillojë në mënyrë konfidenciale nëse kam dyshime për sinjalizimin?**

Ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve si dhe aktet nënligjore synojnë që të krijonë kushtet që individët ta shohin të pranueshme dhe të ndihen të sigurt për të denoncuar akte korruptive në dëm të publikut. Megjithatë sado të detajuara, ligjet dhe rregulloret nuk mund të parashikojnë të gjitha rrethanat e veçanta të çdo rasti. Kështu që është normale që sinjalizuesit të kenë pyetje, shqetësime dhe pasigurira në lidhje me atë që do të donin të sinjalizonin.

Për këtë qëllim, ligji parashikon si detyrim të Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për të ofruar këshillim dhe mbështetje për sinjalizuesit në mënyrë konfidenciale për çdo aspekt që lidhet me sinjalizimin, hetimin dhe mbrojtjen.







## 47 Cilat janë përgjegjësitë e punëdhënësit në lidhje me sinjalizimin?

Fryma e ligjit kërkon nga punëdhënësit që të krijojnë një mjedis të hapur, transparent dhe të sigurt ku punonjësit të ndjehen të motivuar dhe të sigurtë për të sinjalizuar, nëse konstatojnë akte korruptive.

Për të lehtësuar sinjalizimin, ligji parashikon që institucionet publike dhe ndërmarrjet private të miratojnë rregullore të brendshme të posaçme për procedurën e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit.



## 48 Çfarë mund të pres mbasi kam bërë një sinjalizim?

Në përgjithësi mund të ballafaqoheni me dy forma reagimi kur sinjalizimi bëhet i njohur. Së pari, shumë njerëz do t'ju respektojnë për guximin dhe kurajon e treguar për të sinjalizuar aktin e dëmshëm për interesin publik dhe mund të merrni lavdërat apo edhe t'ju trajtojnë si një hero.

Së dyti, ju mund të bëheni viktimë e hakmarrjes në vendin tuaj të punës. Mundet që edhe miq dhe kolegë të distancohen apo dhe t'ju braktisin. Dikush mund edhe t'ju sulmojë verbalisht apo fizikisht. Të tjerët mund të hakmerren duke u përpjekur t'ju dëmtojnë ju ose anëtarë të familjes ose të përpiqen të dëmtojnë pronën tuaj.

Nëse besoni se ju jeni duke u viktimizuar, ose rrezikoheni të viktimizoheni për shkak të sinjalizimit, duhet të raportoni në njesinë përgjegjëse ose në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.



## 49 A mund të sinjalizoj nëse punoj në një institucion i cili trajton informacione të kalifikuara sekret?


Po. Akte korruptive ndodhin dhe në institucionet e sigurisë dhe për këtë ligji për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve nuk i përjashton këto institucione nga detyrimi për të ngritur njësitë përgjegjëse për të marrë dhe hetuar sinjalizime.

Për të mbrojtur informacionin e klasifikuar sekret, ligji parashikon detyrimin e sinjalizuesve dhe njesive përgjegjëse për të ruajtur sekretin shtetëror si gjatë marrjes së sinjalizimit ashtu edhe gjatë hetimit apo mbrojtjes së sinjalizuesit.



## 50 Për sa kohë ruhen të dhënat personale të sinjalizimit?

Në veprimtarinë e tyre njësitë përgjegjëse dhe Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave zbatojnë kërkesat e Ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat personale në dokumentacionin e mbajtur prej tyre ruhen për një periudhë 60 ditë mbas marrjes së vendimit për përfundimin e hetimit administrativ. Në rastet ku nuk fillohet një hetim administrativ, të dhënat personale shkatërohen menjëherë mbas marrjes së vendimit për mosfillimin e hetimit.





Ky udhërrëfyes u realizua nga  
Koalicioni i Europës Juglindore për Mbrojtjen e Sinjalizuesve  
me mbështetjen e National Endowment for Democracy  
Autor: Arjan Dyrmishi

Pikëpamjet dhe mesazhet e përcjella dhe të shprehura në këtë udhëzues janë të autorit  
dhe ilustruesit dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet, mendimet apo qëndrimet e NED apo Koalicionit.

Te gjitha te drejtat jane te autorit



Udhërrëfyes për Sinjalizimin  
dhe Sinjalizuesit  
në Shqipëri

